

# RESPEKTIMI I PARIMIT TË PREZUMIMIT TË PAFAJËSISË, NJË SFIDË E PËRHERSHME PËR GJYKATAT

**Përgatitën:** Sokol BINAJ, *Gjyqtar, Gjykata e Lartë*  
Amarildo LAÇI, *Pedagog, Shkolla e Magjistraturës*

## 1. Si duhet kuptuar parimi i prezumimit të pafajësisë?

Parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se, një person, që organi i akuzës i ka atribuuar kryerjen e një veprë penale, konsiderohet sikur nuk e ka kryer atë, deri në momentin që një gjykatë kompetente do të krijojë bindjen dhe do të vendosë, nëpërmjet një vendim gjyqësor të formës së prerë, që ai është i fajshëm penalisht për kryerjen e faktit penal.

Prezumimi i pafajësisë konfirmon besimin tonë te njerëzit; ai është shprehje e besimit që, gjer në provën e kundërt, njerëzit janë të ndershëm dhe të respektueshëm ndaj ligjit.<sup>1</sup> Do të ishte e papranueshme që të dënohej një person i pafajshëm, rrjedhimisht personit të akuzuar i duhet garantuar një e drejtë e tillë, duke pasur në konsideratë edhe pozitën e tij të pafavorshme, ku gjendet. Vetëm kështu mund të sigurohet njëfarë ekuilibri ndërmjet akuzës dhe të akuzuarit. Po kështu, prezumimi është në pajtim me dinjitetin njerëzor, pasi e konsideron personin e ndjekur penalisht si një qenie njerëzore, subjekt dhe mbajtës i të drejtave individuale.<sup>2</sup> Të gjithë këto argumente nuk shërbejnë për të çuar në një konceptim absolut të prezumimit, por për ta afirmuar atë.

Parimi i prezumimit të pafajësisë nënkupton se, jo vetëm që i pandehuri nuk mund të quhet i fajshëm derisa vendimi gjyqësor i dënimit merr formë të prerë, por edhe se gjatë procesit gjyqësor barra e provës për të provuar autorësinë e të pandehurit në kryerjen e veprës penale që i atribuohet, i takon ekskluzivisht organit të prokurorisë. Me fjalë të tjera, nuk i takon të pandehurit të provojë pafajësinë e tij, por shtetit që të provojë tej çdo dyshimi të arsyeshëm që i akuzuari është fajtor. I pandehuri e zgjedh vetë strategjinë e mbrojtjes: duke paraqitur prova që do t'i çmonte të nevojshme për të provuar alibinë e tij; duke u mjaftuar me kundërshtimin e vërtetësisë dhe fuqisë provuese të provave e paraqitura nga organi i akuzës; duke qëndruar tërësisht pasiv gjatë gjithë gjykimit apo, madje, duke mos marrë pjesë fare në seancë gjyqësore.

Është detyrë e shtetit të provojë fajësinë e një të akuzuari dhe çdo dyshim duhet shkojë në favor të të pandehurit (*in dubio pro reo*). Këtij të fundit duhet t'i garantohet e drejta për të mos iu përgjigjur

---

<sup>1</sup> P. Béliveau dhe J. Pradel “*La justice pénale dans les droits canadien et français*”, 1986, shtëpia botuese Blais (Montréal-Kanada) e Cujas (Paris-Francë), f. 55 e 56.

<sup>2</sup> K. Tiedemann, raport i përgjithshëm i Konferencës së Tolède-s, prill 1992, mbi “*Les mouvements de reforme de la procédure pénale et la protection des droits de l’homme*”, *Revue International de Droit Pénal*, 1993, volumi 64, f. 824.

pyetjeve që mund t'i bëhen nga organet e ndjekjes penale dhe ato gjyqësore. Të akuzuarit nuk duhet t'i kërkohet të paraqesë prova që e inkriminojnë atë.

Edhe pse prezumimi i pafajësisë është prezumim ligjor, pasi parashikohet në ligj, ai është i thjeshtë, joabsolut, në kuptimin që ai mund të rrëzohet nga provat e kundërta. Prezumimi i pafajësisë nuk është gjë tjetër, veçse një mundësi, apo më mirë të themi një probabilitet i pafajësisë së një personi të prekur nga veprimi i drejtësisë penale.<sup>3</sup>

Britania e Madhe është vendi ku ky parim është parashikuar për herë të parë, në vitin 1689 në “*Bill of Rights*”. Prezumimi i pafajësisë sollti një revolucion të vërtetë në procedurën penale, në drejtim të garantimit të të drejtave të personave të akuzuar, duke ia ngarkuar (kaluar) barrën e provimit të akuzës shtetit. Vite më vonë ky parim themelor i procesit të drejtë u pasurua me një sërë të drejtash të tjera për të pandehurit, në funksion të mbrojtjes më të mirë të këtij parimi, si e drejta për të heshtur, për të mos inkrimnuar veten dhe familjarët e tij, për të mos prodhuar prova në dëm të tij etj. Nuk duhet harruar se përpara parashikimit të këtij parimi, të pandehurit i binte barra e provës të vërtetonte pafajësinë e tij, pasi ky i fundit konsiderohej i fajshëm që në momentin që atij i atribuohesh kryerja e një veprë penale.

Në këtë kontekst historik, një rol të rëndësishëm për përfaqimin e këtij parimi në Francë, por edhe për vende të tjera të Evropës, luajti edhe deklarata e mbretit Luigj i XVI-të, në datë 1 maj 1788, sipas të cilës, prezumimi i pafajësisë është : “*i pari ndërmjet të gjithë parimeve në fushën penale ... që do të thotë që një i akuzuar, edhe pse i dënuar në shkallë të parë, duhet konsideruar ende i pafajshëm në vështrim të ligjit, gjersa ky vendim të jetë konfirmuar në instancë të fundit*”.<sup>4</sup> Ky parim gjeti shprehje në Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit, të gushtit të vitit 1789, neni 9, sipas të cilit: “*Çdo person prezumohet i pafajshëm derisa të mos jetë deklaruar fajtor*”.

## **2. Aktet normative, ku është sanksionuar parimi i prezumimit të pafajësisë**

Në vendin tonë parimi i prezumimit të pafajësisë, ka vlerë kushtetuese, pasi parashikohet nga neni 30 i saj, sipas të cilit: “*Kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë*”, por edhe ligjore, sepse sanksionohet në nenin 4 të Kodit të Procedurës Penale, me këtë përmbajtje: “*I pandehuri prezumohet i pafajshëm gjersa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë. Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit*”.

Ky parim është parashikuar në nivel global, në nenin 11§1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, me rezolutën e saj 217 A (III), në datë 10 dhjetor 1948. Kjo dispozitë sanksionon: “*Çdo njeri i akuzuar për një veprë penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij të jetë provuar ligjërisht gjatë një procesi publik, ku të jenë siguruar garancitë e nevojshme për mbrojtjen e tij*”.

<sup>3</sup> Shih Jean Pradel “*Manuel de Procédure Pénale*”, 14<sup>e</sup> Édition, Revue et Augmentée, shtëpia botuese “Cujas”, Paris, gusht 2008, f. 336.

<sup>4</sup> T. Isambert, 28, f. 526 e në vijim, cituar nga vepra e autorit Jean Pradel “*Manuel de Procédure Pénale*”, e sipërcituar, f. 337.

Ky instrument mjaft i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e shpalljes, njohjes dhe zbatimit universal e efektiv të të drejtave të parashikuara në të, u pasua shpejt me miratimin në rang rajonal (evropian), nga Asambleja e Përgjithshme e Këshillit të Evropës, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ), në Romë, më 4 shtator 1950. Ky akt ndërkombëtar, në paragrafin e dytë, të nenit 6 të tij “E drejta për një proces të rregullt”, e përkufizon kështu parimin e prezumimit të pafajësisë: “Çdo person i akuzuar për kryerjen e një vepre penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij nuk është vendosur ligjërisht”.

Kjo e drejtë themelore e individit për t’u konsideruar i pafajshëm nuk ka gjetur vetëm njohje, por edhe zbatim në nivel evropian, nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (këtu e më poshtë “GJEDNJ”), që e ka shndërruar prezumimin e pafajësisë në një element përcaktues të të drejtës për në një proces të rregullt ligjor, duke krijuar një jurisprudencë të bollshme.

Në vende të tjera, prezumimi i pafajësisë është sanksionuar në Kushtetutë (Itali, Poloni, Kanada etj.), apo në kodet e procedurës penale (një numër shumë i madh shtetesh), apo edhe në jurisprudencë (Angli)<sup>5</sup>. Gjithsesi, edhe pse prezumimi i pafajësisë është një parim i njohur në të gjitha shtetet evropiane, zbatimi i tij konkret ndryshon në bazë të sistemeve juridike kombëtare. Kjo manifestohet tek arrestimet/ndalimet që i nënshtrohet një i dyshuar, e sidomos tek prania e mbrojtësit në këtë fazë; tek paraburgimi; tek rregullat mbi provat; tek ekzistenca e rrugëve të ankimit të vendimeve etj.

Kështu, ende sot nuk është gjetur ekuilibri i duhur ndërmjet lirisë së shtypit dhe prezumimit të pafajësisë, duke mos u garantuar ai njëlloj në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, në fushën e provave, disa vende si Gjermania, kanë qenë vazhdimisht kundër çdo prezumimi të fajësisë, ndërkohë që vende të tjera, si Franca, njohin disa prezumime të fajësisë, që sjellin si pasojë kalimin e barrës së të provuarit nga organi i akuzës, tek personi që shkel ligjin. P.sh. neni L. 121-2 i Kodit Rrugor francez sanksionon që mbajtësi i patentës është fajtor për parkim të gabuar të mjetit të tij, ndaj i takon atij barra e provës për të vërtetuar identitetin e vërtetë të kundërvajtësit ose ndodhjen e një rasti të forcës madhore.<sup>6</sup>

### **3. Aspektet e shfaqjes së parimit të prezumimit të pafajësisë në jurisprudencën e GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë**

GJEDNJ ka elaboruar një praktikë gjyqësore të pasur në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, duke e konsideruar atë si një elementet të qenësishëm të parimit të procesit të drejtë, sanksionuar në nenin 6§2 të KEDNJ-së. Në këtë ndarje të këtij punimi do të përqipemi të përcjellim një pjesë të kësaj praktike gjyqësore në lidhje me interpretimin që Gjykata e Strasburgut iu ka bërë elementëve përbërës të këtij parimi.

#### **i) Shmangia e paragjykit të fajësisë së të pandehurve nga ana e gjyqtarëve**

---

<sup>5</sup> Dhoma e Lordëve, *çështja Woolmington*, viti 1935, cituar nga vepra e Jean Pradel “*Manuel de Procédure Pénale*”, e sipërcituar, f. 338.

<sup>6</sup> Shih diskutimin e z. Pierre Fauchon, mbi Librin e Gjellbërt të Bashkimit Evropian “*Mbi prezumimin e pafajësisë*”, f. 2, në <http://www.senat.fr/ue/pac/E3134.html>.

Fajësia e të pandehurit duhet provuar gjatë procesit gjyqësor që duhet zhvillohet duke garantuar të gjitha rregullat dhe parimet e një gjykimi të drejtë, objektiv, të pavarur dhe të paanshëm. Si pasojë nuk gjenden hapësira për deklaratat/deklarime gjyqësore fajësie përpara procesit gjyqësor dhe jashtë tij.

GJEDNJ është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate, nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet<sup>7</sup>; se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit që të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. **Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori tek mbrojtja.**<sup>8</sup>

Është detyrë e gjykatës që shqyrton një çështje penale që t'i krijojë mundësinë të pandehurit vetë, ose nëpërmjet avokatit, të mbrohet, dhe ajo të japë vendimin e saj të bazuar mbi provat direkte e indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza dhe që ndodhen të përfshira në fashikullin e gjykimit.<sup>9</sup> Paragjykimet e mundshme nuk janë në linjë me rëndësinë e rolit që iu është ngarkuar të kryejnë gjyqtarët, në dhënien e drejtësisë, ndaj, nëse në sjelljen e gjyqtarëve vihen re veprime të tilla paragjykuese, që vënë në dyshim paanësinë e tyre subjektive, i takon pjesëmarrësve në proces, që, në përputhje me ligjin procedural kombëtar, të kërkojnë largimin/përrjashtimin e këtyre gjyqtarëve nga procesi gjyqësor.

I pandehuri duhet trajtuar sikur nuk e ka kryer veprën penale që i atribuohet gjersa Shteti, nëpërmjet organit të ngarkuar me fillimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq, të paraqesë prova të mjaftueshme që arrijnë të bindin një gjykatë të pavarur dhe të paanshme për fajësinë e tij. Asnjë gjykatë nuk duhet ta deklarojë fajtor një të pandehur përpara se të marrë një vendim gjyqësor përfundimtar, që ka marrë fuqinë e *res judicata*, me të cilin e gjen fajtor për kryerjen e një fakti penal të dënueshëm.

Gjykata jonë Kushtetuese ka theksuar se, prezumimi i pafajësisë është një nga elementët përbërës të procesit të rregullt ligjor. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuza.<sup>10</sup>

GJEDNJ-a, e cila në çështjen *Allenet de Ribemont kundër Francës*, datë 10 shkurt 1995, paragrafi 35, ka theksuar se: “Prezumimi i pafajësisë është një nga elementët e procesit të rregullt ligjor që

<sup>7</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, datë 6 dhjetor 1988, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-57429>, paragrafi 77.

<sup>8</sup> Shih vendimet e GJEDNJ-së: *Minelli kundër Zvicrës*, datë 25 mars 1983, kërkesa nr. 8660/79, A 62 (1983); *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 8 shkurt 1996, kërkesa nr. 18731/91, në përmbledhjen 1996-I; *Telfner kundër Austrisë*, datë 20 mars 2001, kërkesa nr. 33501/96.

<sup>9</sup> Shih vendimin nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>10</sup> Shih vendimin nr. 23, datë 23.07.2009, të Gjykatës Kushtetuese, § 37, në: [https://www.gjk.gov.al/include\\_php/previewdoc.php?id\\_kerkesa\\_vendimi=706&nr\\_vendim=1](https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=706&nr_vendim=1)

parashikohet në nenin 6, paragrafi 2. Ky parim konsiderohet i shkelur nëse një vendim gjyqësor, që i përket një individit të akuzuar penalisht, reflekton një opinion që ai është fajtor përpara se të jetë provuar fajësia e tij sipas ligjit. Edhe nëse nuk ka ndonjë konkluzion formal, mjafton që të ketë një arsytim i cili lë të kuptohet se gjykata e konsideron të akuzuarin fajtor”. Nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura Gjykatës, nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Bazuar në sa sipër, Gjykata çmon se nuk është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë së kërkuesit.<sup>11</sup>

Në një vendim tjetër<sup>12</sup>, Gjykata Kushtetuese, në verifikim të pretendimit të kërkuesit A.G. se gjyqtarët e magjistraturës së zakonshme kanë dhunuar parimin e prezumimit të pafajësisë, ka arsytuar: “Nga vlerësimi në tërësi i materialeve paraqitur Gjykatës Kushtetuese, nuk rezulton ndonjë e dhënë e cila të tregojë se anëtarët e gjykatave të zakonshme që kanë shqyrtuar çështjen e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale. Dosja gjyqësore nuk përmban ndonjë deklaram formal apo arsytim, i cili të tregojë se anëtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë, të Apelit apo Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë e konsiderojnë kërkuesin fajtor përpara se të jepet një vendim përfundimtar për fajësinë e tij. Vendimi për masën e sigurisë arrest me burg dhe vendimi lidhur me sigurimin e provës nuk përmbajnë deklaratata apo arsytime, të cilat sugjerojnë se gjykatat e zakonshme e konsiderojnë kërkuesin si fajtor”.

*Gjykata e Strasburgut ka theksuar se një gjyqtar apo një zyrtar publik nuk mund ta konsiderojë fajtor një të pandehur për akuzat që i janë atribuuar atij, nëse ky i fundit nuk është gjykuar dhe dënuar për të tilla shkelje penale. Formon shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë rasti kur, edhe pse nuk është provuar plotësisht fajësia e të pandehurit dhe atij nuk i është dhënë mundësia për të ushtruar të drejtat e mbrojtjes, vendimi gjyqësor i dënimit të jetë rezultat i opinionit që ai është fajtor.*<sup>13</sup>

*Rreziku i dhënies së vendimeve gjyqësore të mbështetura mbi opinionin personal, në vend që të bazohen në provat e shqyrtuara në debatin gjyqësor, nuk duhet të na habisë, pasi, për fat të mirë, vendimet gjyqësore i nënshtrohen procedurës së kontrollit të tyre në gjykatat më të larta, mbi bazën e ankimeve të personave të interesuar, ku jo rrallë vendime të tilla rrëzohen (ndryshohen apo prishen). Gjithsesi, shpeshherë krijohet përshtypja se, ka shumë konfuzion mbi vetë konceptin e fajësisë së një personi të caktuar dhe elementëve provues të çështjes. Nuk janë të pakta rastet e mbrojtjeve të të pandehurve që luftojnë, përgjatë një hetimi gjyqësor të stërzgatur, me prova e kundërprova, duke gjeneruar një sens të dukshëm pasigurie që shpesh përfundon me sulmimin e vetë veprimtarisë së gjyqtarëve.*

Në gjykime të tilla, gjyqtarët transformohen nga “vëzhgues” të zbatimit korrekt të rregullave procedurale, në “subjekte të vëzhguara” nga opinioni publik, i cili kërkon të thotë edhe ai mendimin e tij, duke e bërë edhe më të vështirë punën e gjyqtarëve në dhënien e drejtësisë. Një

---

<sup>11</sup> Shih vendimin nr. 47, datë 07.11.2011, të Gjykatës Kushtetuese. Në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese në lidhje me cenimin parimit të prezumimit të pafajësisë, kërkuesi O.SH. ka parashtruar dy argumente: së pari, gjykata, duke u mbështetur në prova të marra në mënyrë të paligjshme, ka prezumuar fajësinë e tij, dhe së dyti, zyrtarë të shtetit të kohës kanë bërë deklaratata të ndryshme publike në lidhje me fajësinë e tij, pa mbaruar ende procesi gjyqësor.

<sup>12</sup> Vendimi nr. 23, datë 23.07.2009, i Gjykatës Kushtetuese, i sipërcituar.

<sup>13</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së *Minelli kundër Zvicrës*, i sipërcituar, paragrafi 38.

shembull tipik është kërkesa e publikut për dënime ekzemplare, apo forumet në media apo në internet ku ndeshen ithtarët e fajësisë dhe të pafajësisë së një personi të dyshuar. Në të gjitha rastet harrohet një fakt elementar: se garancitë e dhëna në mbrojtje të parimit të prezumimit të pafajësisë janë një instrument i domosdoshëm për t'u siguruar se të gjithë kanë të drejtë të mbrohen nga akuzat e ngritura kundër tyre; gjyqtari, duke ndërhyrë *post factum* nuk ka mjet tjetër për të përcaktuar fajësinë e mundshme të të pandehurit, përveç marrjes së materialit provues, të cilin do ta vlerësojë duke respektuar rregullat procedurale. Ajo që shumë vetë injorojnë është fakti se kryerja e një veprë penale nuk sjell gjithmonë si pasojë të detyrueshme individualizimin e autorit dhe dënimin e tij, përkundrazi, historia na ka mësuar se shpesh, shumë vepra penale jo vetëm nuk sjellin për pasojë dënimin e autorit, por ekzistojnë një sërë mekanizmash që jo rrallë bëjnë që të dështojë veprimtaria e gjykatës.<sup>14</sup>

*Gjykata ka për detyrë të zbulojë të vërtetën ashtu siç i rezulton në proces, nga shqyrtimi në tërësi i provave të nënshtuara shqyrtimit gjyqësor, pa i dhënë asnjërës fuqi të paracaktuar (neni 152 i KPP). Kjo e vërtetë, që në doktrinë njihet si “e vërteta procesuale”, jo gjithmonë mund të jetë e vërteta objektive, se si ka ndodhur realisht fakti penal. Po të mos ishte kështu, nuk do të ndodheshim përpara rasteve, fatmirësisht të rralla, kur persona të pafajshëm janë dënuar dhe persona fajtorë kanë marrë pafajësinë, nëpërmjet vendimeve gjyqësore.*

Në çdo proces gjyqësor ndeshen dy teza të kundërta (akuza dhe mbrojtja), që rreken të bindin gjykatën që versioni i tyre i përgjigjet të vërtetës dhe duhet të pranohet. Siç e dimë të gjithë, e vërteta karakterizohet nga i ashtuquajtimi parim i vetëpërrjashtimit, sipas të cilit: ajo çka është e vërtetë nuk pranon kontradikta, pra është një e vërtetë për të cilën nuk ka dyshime. Në kontekstin procesual, për të shpëtuar nga kjo rrugë pa krye, (diferencën ndërmjet të vërtetës objektive dhe asaj që rezulton në shqyrtimin gjyqësor - shënimi ynë), na vjen në ndihmë “e vërteta procesuale”, që shpesh është shumë më komode dhe e sigurtë, por edhe më e thjeshtë për t'u vërtetuar.<sup>15</sup>

Në përputhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, *askush nuk duhet të paraburgoset, veçse kur ekzistojnë dyshime të arsyeshme që një person e ka kryer veprën penale dhe se rëndësia e faktit penal dhe e autorit të veprës nuk të lënë zgjidhje tjetër, përveçse kufizimit të lirisë personale.* Gjithsesi, nëse një person është paraburgosur deri në përfundim të gjykimit të tij, ai duhet të përfitojë apo duhet t'i ofrohen nga organet penitenciare kushte të përafërta me pafajësinë e tij të prezumuar. *Kufizimet e lirisë personale përpara dhënies së dënimin përfundimtar nga gjykata janë të pranueshme në pikëpamje kushtetuese, me kushtin që t'i jepet zgjidhje trajtimit ndaj të pandehurit, duke shmangur çdo zbatim të parimit të fajësisë; cilido qoftë qëllimi i “paraburgimit” (arrestit parandalues) që e konsideron të pandehurin përgjegjës (fajtor) për faktin penal që i atribuohet, del jashtë profilin kushtetutshmërisht të pranuar.*<sup>16</sup>

Jurisprudenca e GJEDNJ-së ka përcaktuar tregues të qartë në lidhje me elementët përbërës të prezumimit të pafajësisë. Vetëm personat “*kundër të cilëve është ngritur një akuzë penale nga*

---

<sup>14</sup> Giovanni Catalisano, “*Il libro verde sulla presunzione di non colpevolezza*”, artikull i botuar në <http://altalex.com/index.php?idnot+50281>

<sup>15</sup> Po aty.

<sup>16</sup> G. Fiandaca e G. Di Chiara, “*Una introduzione al sistema penale. Per una lettura costituzionalmente orientata*”, Jovene, Napoli, 2003, p. 315-316.

*organi i prokurorisë*<sup>17</sup> mund të përfitojnë nga zbatimi dhe mbrojtja që ofron ky parim. Ky është një moment i rëndësishëm, sepse përpara se të marrë cilësinë e të pandehurit<sup>18</sup> një person i dyshuar për kryerjen e një veprë penale i nënshtrohet vlerësimit dhe hetimit nga organi i prokurorisë, hetim i cili mund të mos fillojë, pasi *prima facie* konstatohet se nuk ka asnjë element fajësues për personin (neni 290 i KPP); mund të përfundojë me pushimin e çështjes/akuzës (neni 328 i KPP) ose, nëse grumbullohen prova të plota për fajësinë e të pandehurit, organi i ndjekjes penale paraqet kërkesën për gjykim.

## ii) Barra e provës

Sipas një rregulli ndërkombëtarisht të njohur, *organit të akuzës i takon detyrimi që të vërtetojë fajësinë e një të akuzuari përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*.<sup>19</sup> GJEDNJ ka arsyetuar që: “*barra e provës peshon mbi akuzën dhe nga dyshimi duhet të përfitojë i akuzuari. Nga ana tjetër, i takon atij (...) të ofrojë prova të mjaftueshme për të mbështetur një konkluzion fajësie.*”<sup>20</sup>

Procesi i të provuarit udhëhiqet nga parimi i prezumimit të pafajësisë. Kjo do të thotë që prezumimi i pafajësisë është parimi i parë e drejtues dhe të gjithë parimet e tjera zënë fill pas tij.<sup>21</sup> Në të drejtën e provave është normale të bëhet dallimi ndërmjet barrës së provës dhe mjeteve të provave (provave), ku, ndërsa si rregull, barra e provës i takon akuzës, mjetet e provave mund të përdoret lirisht nga palët në procedimin penal për të provuar faktet objekt akuze (prokuroria) ose alibinë e të pandehurit, apo pretendimet e tij që mund ta shfajësojnë a lehtësojnë pozitën e tij penale.

Parë në këtë këndvështrim Gjykata e Strasburgut nuk lejon derogime të barrës së provës në procesin penal, pra nuk lejon prezumimin e fajësisë. Siç do ta shohim edhe më poshtë, nuk ndodh gjithmonë kështu. Gjithashtu, edhe jurisprudenca e gjykatave kushtetuese evropiane nuk është identike.

*Gjykata Kushtetuese spanjolle*, për shembull, përdor thelbësisht parimin e prezumimit të pafajësisë kur ajo kontrollon procesin provues në një procedim penal. Sipas kësaj gjykate, prezumimi i pafajësisë ka kaluar nga statusi i parimit themelor të së drejtës, në statusin e një të drejte themelore që lidh të gjitha pushtetet publike dhe imponon një proces minimum provueshmërie të rrethuar nga të gjitha garancitë (e një procesi të drejtë - shënimi ynë) nga të cilat nxirret përfundimi në lidhje me fajësinë e të akuzuarit.<sup>22</sup> *Kjo gjykatë e ka kufizuar fushën e veprimit të prezumimit të pafajësisë vetëm në faktet që përbëjnë objekt të të provuarit në një gjykim*, pasi, sipas saj, procesi i cilësimit juridik të fakteve penale dhe interpretimi i ligjit janë në kompetencë të gjyqtarit të çështjes, ndaj i “shpëtojnë” zbatimit të këtij parimi. Për këtë gjykatë, çdo parim i prezumimit të fajësisë është jokushtetues.

<sup>17</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së mbi pranueshmërinë, *X. kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, çështja nr. 4483/70.

<sup>18</sup> Në nenin 34, pika 1 të KPP parashikohet: “*Merr cilësinë e të pandehurit personi të cilit i atribuohet vepra penale me aktin e njoftimit të akuzës, në të cilin tregohen të dhënat e mjaftueshme për marrjen të pandehur. Ky akt i njoftohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij.*”

<sup>19</sup> Shih “*Livre Vert sur la présomption d’innocence*” të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 26.4.2006, COM (2006) 174, në [https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/fr/com/2006/com2006\\_0174fr01.pdf](https://eur-lex.europa.eu/LexUriServ/site/fr/com/2006/com2006_0174fr01.pdf), f. 6.

<sup>20</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së *Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës*, të sipërcituar.

<sup>21</sup> Christine Lazerges “*La présomption d’innocence en Europe*”, vepër e sipërcituar, f. 6.

<sup>22</sup> Po aty, f. 7.

Në dallim nga Gjykata Kushtetuese spanjolle, *Këshilli Kushtetues francez, në raste të jashtëzakonshme, e ka pranuar kalimin e barrës së provës nga organi i akuzës tek shkelësi i ligjit*, pra, duke pranuar prezumimin e fajësisë. Të tilla parime mund të vendosen, sidomos kur flitet për kundërvajtje, *mjafton të plotësohen kushtet e mëposhtme: të mos bëhet fjalë për parime të pakundërshtueshme; të jetë siguruar e drejta e mbrojtjes dhe faktet të çojnë në mënyrë të arsyeshme në vërtetimin e përgjegjësisë penale*. Këshilli Kushtetues francez verifikon nëse kushtet e mësipërme janë të plotësuar nga ligji që parashikon të tilla prezumime, por ky organ ka refuzuar t'i shtrijë jashtë fushës penale pasojat e prezumimit të pafajësisë në lëndën e provave.

Këtë qëndrim, ky Këshill, e ka mbajtur gjatë shqyrtimit të kushtetutshmërisë të një projekt-ligji, i cili e kalonte barrën e provës nga akuza tek i pandehuri, në rastet kur ai akuzohej për veprën penale të ngacmimit seksual, duke arsyetuar: *“rregullat shmangëse të normimit të barrës së provës në favor të personave që pretendojnë të jenë ngacmuar seksualisht nuk janë të zbatueshme në fushën penale, sepse kanë pasur si objekt apo për efekt të shkaktojnë cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë”*.<sup>23</sup>

*Gjykata jonë Kushtetuese*<sup>24</sup>, në përgjigje të pretendimeve të kërkuesit G.L., për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë, -pasi interpretimi i gabuar i nenit 283/1 i Kodit Penal nga gjykatat e zakonshme, mosvlerësimi në favor të tij të dyshimeve nëse ai është përdorues droge, si dhe konkludimi i fajësisë duke u nisur vetëm nga sasia e lëndës narkotike që i është sekuestruar kërkuesit, duke kaluar barrën e provës për vërtetimin e akuzës nga prokurori tek i pandehuri, - ka theksuar se: *“Gjithashtu, vlerësohen të pabazuara pretendimet e kërkuesit për kalimin e barrës së provës nga prokurori tek i gjykuari, për mosvlerësim të dyshimeve në favor të tij apo për përcaktimin e fajësisë pa prova të provuara nga prokurori, pasi këto nuk gjejnë pasqyrim në aktet dhe materialet gjyqësore. Në këto rrethana vlerësohet se nuk është cenuar asnjë nga aspektet e parimit të prezumimit të pafajësisë”*.

*Në një vendim tjetër*<sup>25</sup>, *Gjykata Kushtetuese*, duke rrëzuar pretendimet e kërkuesit H.D. për cenim të parimit të prezumimit të pafajësisë, - për shkak të mosprovimit të fajësisë së tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, duke u bazuar në mënyrën e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe në analizën e provave në mënyrë përjashtuese për dy të pandehurit e tjerë, ndërkohë që nuk i ka analizuar pretendimet e kërkuesit, - ka arsyetuar se: *“Çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe ky parim do të konsiderohej i cenuar nëse barra e provës do të kalonte nga akuza tek i pandehuri. Detyrë e gjykatës së zakonshme që shqyrton një çështje penale është që t'i krijojë mundësinë të pandehurit vetë, ose nëpërmjet mbrojtësit, të mbrohet, dhe ajo të japë vendimin e saj të bazuar mbi provat direkte e indirekte, të cilat duhet të provohen nga akuza dhe që administrohen në dosje. Në kuptimin që paraqet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, KEDNJ-a, si dhe nga qëndrimi që mban jurisprudenca në këtë drejtim, pretendimi për shkeljen e këtij standardi kushtetues kërkon domosdoshmërisht që në një proces gjyqësor të evidentohen dhe provohen saktë të gjithë ato elementë thelbësorë të cilat mund të kenë sjellë deklarinimin fajtor të të pandehurit mbi bazën e dyshimeve dhe që e kanë bërë gjykatën të sillt si e njëanshme në dhënien e vendimit të*

<sup>23</sup> Vendimi nr. 2001-455, datë 12 janar 2001 i Këshillit Kushtetues (*Conseil Constitutionnel*) francez, i aksesueshëm në: <https://www.conseil-constitutionnel.fr/decision/2002/2001455DC.htm>

<sup>24</sup> Shih vendimin nr. 16, datë 15.06.2009 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>25</sup> Shih vendimin nr. 09, datë 28.04.2009 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.



saj. Nga arsyetimi i vendimit gjyqësor nuk rezulton që gjykata të ketë aplikuar dënimin e kërkuarit me bindjen se ai është fajtor që në fillim të procesit dhe pa e mbështetur atë në prova. Në një gjykim të karakterit kushtetues është tepër e rëndësishme që, kur analizohen pretendimet për shkelje të parimit të prezumimit të pafajësisë, të mos përqendrohet kontrolli kushtetues në mënyrën e vlerësimit dhe të çmuarjes së provave që mund t'i ketë bërë në vendimin e saj gjykata që e ka gjykuar çështjen në thelb”.

**Parimi i prezumimit të pafajësisë është njohur dhe zbatuar në mënyrë konsekuente edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë.** Për interes të këtij punimi do të mjaftoheshim në citimin e disa vendimeve gjyqësore ku kjo Gjykatë, në konformitet apo kontrast me gjykatat më të ulëta, ka zbatuar këtë parim, duke tërhequr vëmendjen e këtyre gjykatave për një zbatim sa më rigoroz të këtij parimi madhor të procesit të rregullt ligjor.

**Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 734, datë 21.11.2008, ka konstatuar se:** “...Përsa i përket bashkëpunimit, arsytimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas të cilit: “... Të gjitha këto veprime, duke filluar nga gjetja e sendeve të kundërligjshme, modifikimi i serbatorit të makinës, vendosja, fshehja e sendeve në të, dëshira për t'i dërguar ato jashtë kufijve shqiptarë ... nuk mund të bëheshin dhe nuk janë bërë vetëm nga i pandehuri...”, me të drejtë gjykata e apelit e ka konsideruar si të bazuar në prezumime, rrjedhojë të mosmarrjes në konsideratë të disponimeve të neneve 3(2) dhe 382 të KPP. Ky kolegji arrin në përfundimin si më sipër duke u bazuar në parimin e gjithëpranuar procedural të prezumimit jo të fajësisë, por të pafajësisë (në kuptimin e gjerë të termit) së personit të akuzuar, i cili ka gjetur sanksionim në dispozitën e nenit 4 të KPP”.

Ndërsa në **vendimin nr. 600, datë 19.09.2007, Kolegji Penal, ka arsyetuar si vijon:** “...Lidhur me ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale për të gjykuarit, u bazuan në çmimin e konkluzioneve kontradiktore të ekspertimeve mjeko-ligjore që përmbajnë aktet e përpiluara nga specialisti G.N., kontradikta dhe pasaktësi të cilat nuk u bënë objektivist të mundura (për shkak se përbënin veprime të papërsëritshme) të sheshoheshin dhe as të saktësoheshin në një formë e masë të tillë, që t'i jepnin mundësinë reale gjykatave për t'i ballafaquar me shpjegimet e vetë të gjykuarve, si dhe thëniet e dëshmitarëve, të cilat duhet të merren me rezervë, pasi këta të fundit janë në marrëdhënie shumë të afërt farefisnie e krushqie me të parët. Edhe pas dëgjimit në mënyrë të përsëritur të specialistëve të mjekësisë ligjore, si dhe ekspertimit vlerësues përfundimtar që u bë prej specialistëve më të njohur të fushës (Prof. Dr. F.H dhe Prof. Dr. S.M.) akteve të dosjes në këtë aspekt, gjendja e konkluzioneve kontradiktore që u përmend me lart, nuk u bë e mundur as të përmirësohet dhe as të ndryshohet, për t'iu larguar sa më pak mënyrës probabile të paraqitjes dhe shprehjes përpara gjykatave. Në këto rrethana, edhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, megjithëse vëren mangësi të pariparueshme në procesin e të provuarit të këtij procedimi penal, duke vlerësuar objektivist pamundësinë reale në të cilën ishin gjykatat për t'i plotësuar ato, mbështetur edhe në një prej parimeve bazë të procesit tonë penal, sikundër është ai i prezumimit të pafajësisë, sipas të cilit çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit (neni 4 i KPP), ndryshimin e cilësimit ligjor të veprës penale për të gjykuarit e gjen të bërë konform kërkesave të këtij Kodi...”

Në një vendim tjetër të **Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 154, datë 29.03.2006**, ky i fundit, duke riafirmuar se barra e provës për të mbështetur akuzën i takon prokurorit, **ka arsyetuar se:**

“...Organi i prokurorisë ka kryer hetimin e çështjes me të meta të rëndësishme, të cilat kanë pasur influencë dhe në zgjidhjen e çështjes. Nuk është marrë asnjë provë dhe nuk i është paraqitur

gjykatës asnjë e dhënë lidhur me marrëdhëniet midis tre të gjykuarve, në një kohë që J.T. dhe S.Ç., janë nga një fshat, ndërsa i gjykuari A.Ç. (siç shpjegojnë dy të gjykuarit) është nga rrethi i Tropojës dhe banues në Babrru, Tiranë. Përveç kësaj nuk është marrë asnjë provë për qenien ose jo të të gjykuarit A.Ç. në fshatin e të gjykuarve të tjerë në ditët që është kryer vepra penale, gjë që do të ballafaqohej me deklaratimet e bëra nga dëshmitarët e paraqitur nga mbrojtja, që kanë shpjeguar se në kohën që është kryer vepra penale ata kanë qenë në Gjermani, së bashku me të gjykuarin A.Ç.

Hetimi i çështjes, marrja e provave që i përkasin çdo çështjeje penale dhe paraqitja e tyre para gjykatës, është detyrë e organit të prokurorisë, ndërsa vlerësimi i tyre përfundimisht bëhet nga gjykata, e cila me vendim zgjidh çështjen. Moskryerja e të gjitha veprimeve të nevojshme nga prokuroria dhe mosparaqitja e provave që lidhen me kryerjen e veprës penale, mund dhe realisht ndikon në përfundimet e gjykatës, e cila, ndonëse ka të drejtë të marrë edhe vetë prova të reja, nuk mund të zëvendësoje në marrjen e tyre organin e prokurorisë. Në këtë drejtim duhet mbajtur parasysh se sipas KPP marrja e provave dhe paraqitja e tyre para gjykatës bazohet në sistemin akuzator gjë që del nga neni 148 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq, në emër të shtetit”*.

Në rrethanat e sipërme, akuza në drejtim të të gjykuarit A.Ç., mbetet e dyshimtë, gjë që sipas nenit 4 të KPP *“Çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit”*. Mundësia për marrjen e provave të tjera që nuk janë marrë në kohën e duhur është e pakët, duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale kanë kaluar rreth pesë vjet e gjysëm”.

❖ **Duke u bazuar në jurisprudencën e GJEDNJ, Komisioni Evropian ka regjistruar tre raste në të cilat barra e provës nuk peshon tërësisht mbi akuzën:**

- (1) në rastet e veprave penale qartësisht materiale;
- (2) në rastet e veprave penale për të cilat barra e provës ka ndryshuar;
- (3) në rastet e marrjes së vendimeve në lidhje me konfiskimin e pasurisë.

*Në rastin e parë*, akuza duhet të paraqesë prova të mjaftueshme që provojnë se i akuzuari efektivisht ka kryer veprimin fizik (element material) pjesë përbërëse e shkeljes ligjore, por akuza nuk është e detyruar të vërtetojë që ai kishte si qëllim të vepronte në atë mënyrë ose të provokonte këtë rezultat. Kjo procedurë është në konformitet me parimet e KEDNJ-së, edhe pse shteti është i përjashtuar në provimin e “qëllimit kriminal” të të akuzuarit. GJEDNJ ka njohur që legjislacionet penale të shteteve përmbajnë shembuj të veprave penale qartësisht materiale.<sup>26</sup>

Për të tilla shkelje ligjore duhet të provohet vetëm fakti që i akuzuari e ka kryer veprën penale dhe, nëse vërtetohet kryerja e këtij veprimi, parashikohet një parim që e detyron të akuzuarin që të provojë të kundërtën e tij, pra që në veprimet e tij mungon dashja dhe elementë të tjerë të anës subjektive, me qëllim përjashtimin apo lehtësimin e përgjegjësisë penale të tij. Gjykata e Strasburgut ka konstatuar që prezumime të tilla duhet të mbahen brenda limiteve të arsyeshme, duke marrë në konsideratë rëndësinë e rastit konkret në gjykim dhe garantuar të drejtat e mbrojtjes.

Një rast të ngjashëm parashikon edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (Ndërkombëtar), ratifikuar nga vendi ynë, me ligjin nr. 8920, datë 11.7.2002, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 41/2002, në nenin 5<sup>27</sup>, paragrafi i dytë, ku parashikon:

<sup>26</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së *Salabiaku kundër Francës*, datë 07.10.1988, seria A (141), paragrafi 28.

<sup>27</sup> Ky nen parashikon penalizimin e pjesëmarrjes në një grup kriminal të organizuar.

“Dijenja, synimi, qëllimi, plani ose marrëveshja, të cilat përmenden në paragrafin 1 të këtij neni, mund të nxirren nga rrethanat faktike objektive”. Në zbatim të këtij instrumenti ndërkombëtar, i cili është pjesë përbërëse e rendit tonë juridik, madje me fuqi me të lartë se çdo ligj tjetër, përjashtuar Kushtetutën, në rastet e kryerjes së veprave penale që lidhen me forma të veçanta bashkëpunimi<sup>28</sup> organit të akuzës i bie barra e provës të vërtetëvetëm anën objektive të figurës së veprës penale nga i pandehuri, ndërsa elementët e tjerë që lidhen me anën subjektive, prezumohen se provohen nga rrethanat e faktit penal, ashtu siç janë vërtetuar gjatë procesit gjyqësor, në procedurën e kërkimit të së vërtetës procesuale. Të njëjtin parashikim bën edhe Konventa e Vjenës Kundër Trafikut të Paligjshëm të Narkotikëve (miratuar në kuadër të OKB-së), si dhe neni 287 i Kodit Penal “Pastrimi i produkteve të veprës penale”, në paragrafin e fundit të tij. Është e kuptueshme që një prezumim i tillë është i thjeshtë (*juris tantum*) dhe “qëndron në këmbë” deri në paraqitjen e provave të kundërta nga i pandehuri.

**Në rastin e dytë**, akuza duhet të provojë që i pandehuri ka vepruar/reaguar në një mënyrë të caktuar dhe është ky i fundit që duhet të provojë se në veprimet e tij nuk ka asnjë element që ta fajësojë atë apo se veprimet e tij, edhe pse të paligjshme, nuk janë të dënueshme, pasi ato janë kryer në përmbushje të një detyre apo urdhri të ligjshëm, apo më tej, veprimet janë kryer në prezencë të një shkakut padënueshmërie. Në dallim nga rasti i parë i sipërcituar, në këtë rast, të pandehurit i takon edhe më tepër barra e provës për të provuar mungesën e elementëve fajësues në veprimet e tij. Sipas GJEDNJ-së një procedurë e tillë është e pranueshme për veprat penale më pak të rënda.<sup>29</sup>

Edhe pse është një parim gjerësisht i njohur, që organit të akuzës i takon kryesisht dhe përgjithësisht barra e të provuarit në procesin gjyqësor, d.m.th. që i pandehuri që ka sjellë për gjykim është autori i veprave penale që i ka kontestuar dhe për këtë sjellje *contra legem* duhet të mbajë përgjegjësi penale, ndodh, në raste të jashtëzakonshme, si: në rastet e kryerjes së shkeljeve ligjore të lidhura me mosrespektimin e disa detyrimeve administrative; apo moskomunikimi i disa dokumenteve, të cilat, që prej provimit të ekzistencës së detyrimit nga akuza, barra e provës i kalon të pandehurit, i cili duhet të vërtetëvetëm se e ka respektuar këtë detyrim. Në disa raste, gjithashtu, i akuzuari duhet të invokojë një mjet mbrojtjeje, si: mbrojtje e nevojshme, nevojë ekstreme, sëmundje psikike apo zhvillim i metë mendor, apo edhe alibinë, e cila duhet të hidhet poshtë nga organi i akuzës.

**Rasti i tretë** i referohet pasurive të gjetura tek një i pandehur/dyshuar apo të afërm të tij, fakt i cili mund të sjellë kalimin e barrës së provës nga akuza tek personi i dyshuar apo persona të tjerë të lidhur me të, në rast se ka dyshime të bazuara se pasuri të tilla janë vënë si rezultat i ushtrimit të veprimtarive kriminale, që lidhen kryesisht me krimin e organizuar, trafikimin dhe korrupsionin. Krimi i organizuar kërcënon sigurinë kombëtare dhe stabilitetin e vendit, ai i kundërvihet shtetit të së drejtës dhe dëmton ekonominë kombëtare.

Ky kërcënim po përhapet gjithnjë e më shumë në ditët tona, prandaj del i domosdoshëm forcimi i masave kombëtare të përshtatshme për të luftuar me efikasitet kundër kësaj dukurie. Sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë që rrjedh nga aktiviteti kriminal po konsiderohet gjithnjë e më shumë si një nevojë e qenësishme në luftën kundër krimin të organizuar. Kjo e fundit ka në themel një qëllim prevenues: zvogëlimin e financimit të aktiviteteve kriminale, duke penguar riinvestimin e këtyre

<sup>28</sup> Në lidhje me format e veçanta të bashkëpunimit shih nenin 28, të ndryshuar, të Kodit tonë Penal.

<sup>29</sup> *Salabiaku kundër Francës*, vendim i sipërcituar.

të ardhurave në ekonomi dhe, në të njëjtën kohë, shkurajimin e personave që merren me veprimtari të tilla penalisht të ndëshkueshme.

Ky lloj konfiskimi i lejon shtetet që të marrin në pronësinë e tyre pasuritë e kundërligjshme, duke ndërmarrë një procedurë gjyqësore të drejtpërdrejtë kundër personit të dyshuar si të përfshirë në aktivitet kriminal ose pasurisë së tij, pa qenë e nevojshme që ky i fundit të jetë dënuar më parë. Shteti, përgjithësisht, është i detyruar të tregojë, në një nivel të fortë probabiliteti (mundësie) që këto pasuri e kanë prejardhjen drejtpërdrejt apo në mënyrë të tërthortë nga aktivitetet kriminale. Konfiskimi civil synon të pengojë përdorimin e paligjshëm dhe të rrezikshëm për shoqërinë të pasurive, prejardhja e ligjshme e të cilave nuk është bërë e mundur të tregohet.<sup>30</sup>

Përfitimet shumë të mëdha që organizatat e tipit mafioz nxjerrin nga aktivitet e tyre të paligjshme iu japin atyre një pushtet, ku ekzistenca e tyre vë në provë përparësinë e ligjit në një shtet. Kështu, mjetet e adoptuara për të luftuar këtë pushtet ekonomik, posaçërisht konfiskimi gjyqësor (civil), mund të duket si i domosdoshëm për të luftuar me efikasitet kundër organizatave të tilla.<sup>31</sup>

Procedimi i parashikuar në këtë ligj (*ligjin parandalues – shënimi im*) është një procedim i veçantë, autonom, nga procesi penal, ndaj garancitë e procesit penal nuk mund të gjejnë zbatim në këtë proces të rregulluar nga ligji objekt shqyrtimi. Siç e konfirmon edhe neni 5, paragrafi 1, ky ligj rregullon marrëdhënien ndërmjet procedurës së caktimit të masave parandaluese dhe procedimit penal, duke vendosur se “*procedura e caktimit dhe e zbatimit të masave parandaluese, sipas këtij ligji, është autonome nga gjendja, shkalla apo përfundimi i procedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave, subjekte të këtij ligji*”.<sup>32</sup>

Jurisprudenca e GJEDNJ-së, megjithatë, ka elaboruar edhe disa kritere që duhet të përmbushin ligje të tilla që cenojnë të drejtën e pronës së individëve apo personave juridikë, e mirë marrë në mbrojtje nga neni 1, i Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Në gjykimet me objekt të tillë duhet që ligji të parashikojë se vendimet gjyqësore mund të ankimohen në gjykatat më të larta dhe masa të tilla (sekuestroja dhe konfiskimi) duhet të jenë të arsyeshme dhe proporcionale.<sup>33</sup> Pretendimet e ngritura nga personat e tretë që kanë vepruar në *bona fide* duhet të vlerësohen me seriozitet në rastet kur ata ngrenë probleme të cenimit të së drejtës së tyre të pronës dhe shteti duhet të gjejë mekanizma që lejojnë mbrojtjen e interesave të tilla.

Në dallim nga procesi penal, gjykimi parandalues mbështet mbështetet në dyshimin e arsyeshëm, bazuar në indicie, duke iu ngarkuar barra e provës personit të dyshuar dhe personave të tjerë, për të vërtetuar ligjshmërinë, për justifikimin e origjinës së pasurisë. Pra, në këtë proces, barra e provës është e ndarë ndërmjet prokurorit dhe personit të cilit do t’i sekuestrohet ose konfiskohet pasuria.

---

<sup>30</sup> Shih vendimin *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë*, në çështjen nr. 52024/99, datë 5 korrik 2001, të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

<sup>31</sup> Shih vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen *Bongiorno dhe të tjerë kundër Italisë*, nr. 4514/07, datë 5 janar 2010, si dhe vendimin *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë*, në çështjen nr. 52024/99, datë 5 korrik 2001.

<sup>32</sup> Shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me të cilin është konfirmuar kushtetutshmëria e ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.

<sup>33</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së *Welch kundër Britanisë së Madhe*, datë 09.02.1995, çështja nr. 17440/90 dhe *Philips kundër Britanisë së Madhe*, datë 05.07.2001, çështja nr. 41087/98.

Në vijim të këtyre arsytetimeve dhe argumenteve për nevojën e dallimit ndërmjet procesit penal dhe procesit parandalues, garancitë e procesit penal për prezumimin e pafajësisë nuk janë të zbatueshme në procesin parandalues, të sanksionuar nga ligji objekt shqyrtimi.<sup>34</sup>

### iii) E drejta e të akuzuarit për të mos inkriminuar vetveten

Prezumimi i pafajësisë përfshin të drejtën për të mos kontribuar në inkriminimin e vetvetes nga ana e personit të akuzuar, e cila nga ana e saj përfshin të drejtën për të mos folur përpara autoritetit procedues (e drejta për të ruajtur heshtjen e tij) dhe të drejtën për të mos u detyruar nga organet e ndjekjes penale për të prodhuar prova që do të ndikonin në pozitën e tij. E thënë ndryshe, bëhet fjalë për të zbatuar parimin e lashtë romak “*Nemo tenetur prodere seipsum*” (askush nuk mund të detyrohet të akuzojë vetveten). I pandehuri mund të refuzojë t’u përgjigjet pyetjeve, duke mos dhënë “kontributin” e tij në krijimin e elementëve provues, detyrë që i mbetet organit të prokurorisë.

GJEDNJ<sup>35</sup> ka theksuar se, edhe pse nuk është përmendur në mënyrë të shprehur në KEDNJ, e drejta për të mos u vetinkriminuar është një normë ndërkombëtare përgjithësisht e njohur dhe është pjesë integrale e konceptit të “procesit të drejtë”. Ky parim mbron të pandehurin kundër shtrëngimit të padrejtë të autoriteteve shtetërore, duke reduktuar në këtë mënyrë gabimet gjyqësore dhe duke lejuar të zbatohet parimi i barazisë së armëve.

Duke iu referuar Kodit të Procedurës Penale (KPP), dispozitat që rregullojnë marrjen në pyetje të të pandehurit janë nenet 37, 38 dhe 39 të këtij Kodi. Të tri këto nene mund të analizohen vetëm në harmoni me njëri-tjetrin dhe në funksion të respektimit të garancive kushtetuese që burojnë nga nenet 31 dhe 32 të Kushtetutës. Posaçërisht, në nenin 37 të KPP-së, parashikohet se në momentin që personi, i cili akoma nuk ka marrë cilësinë e të pandehurit, bën deklaratime prej të cilave mund të burojnë përgjegjësi penale, organi procedues ndërpret marrjen në pyetje dhe e fton personin që të caktojë një mbrojtës. Prania e mbrojtësit është një kusht i domosdoshëm për vazhdimin e marrjes në pyetje të personit, pasi ndryshe nuk mund të shpjegohet detyrimi për punonjësin e policisë që të ndërpresë marrjen në pyetje. Kjo e bën mbrojtësin ligjor një subjekt të domosdoshëm dhe të pazëvendësueshëm gjatë kryerjes së këtij veprimi procedural dhe, për rrjedhojë, mungesa e tij çon në cenim të nenit 31 të Kushtetutës. Fakti që neni 37 i KPK parashikon ftesën që i bëhet personit që po merret në pyetje që të zgjedhë një mbrojtës nuk mund të lexohet në mënyrën që e ka interpretuar Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, sipas së cilës është e mjaftueshme që mbrojtësi të verifikojë në një moment të mëvonshëm nëse deklaratat e personit të ndaluar janë bërë me vullnetin e tij të lirë. Përkundrazi, Gjykata çmon se mbrojtësi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit dhe, mbi të gjitha, duhet që në çdo rast të kujdeset për interesat e të ndaluarit.<sup>36</sup>

*Akuza duhet të kërkojë t’i bazojë argumentet e saj, pa iu drejtuar provave të marra nëpërmjet shtrëngimit apo presionit. Siguria dhe rendi publik nuk mund të shërbejnë si justifikime për të shkelur këto drejta. Bëhet fjalë për të drejta që janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën, ndaj çdo shtrëngim i ushtruar me qëllim marrjen e provave nga i pandehuri që e implikojnë atë në*

<sup>34</sup> Shih vendimin nr. 4, datë 23.02.2011, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

<sup>35</sup> Shih *Heaney and McGuinness kundër Irlandës*, datë 21.12.2000, çështja nr. 34720/97.

<sup>36</sup> Shih vendimin nr. 14, datë 03.05.2011, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

kryerjen e një vepre penale përbën shkelje të së drejtës për të qëndruar në heshtje, për të mos folur. P.sh. shteti dhuron të drejtën e të pandehurit për të mos folur nëse ai përpiqet ta shtrëngojë atë që të japë deklarime në lidhje me të dhënat bankare të tij hetuesve të shërbimeve doganore.<sup>37</sup>

*Të detyrosh një të akuzuar që ta bashkëpunojë me autoritet e ndjekjes penale gjatë fazës së hetimeve paraprake, mund të shkelë të drejtën e tij për të mos dhënë deklarime apo për të mos paraqitur prova vetinkriminuese dhe të komprometojë paanësinë e gjithë procesit gjyqësor që do të zhvillohet më pas, d.m.th. të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor.*

*Ndalimi i parashikuar nga neni 38(2) i KPP-së që ndaj personit të marrë në pyetje nuk mund të përdoren metoda ose teknika për të ndikuar mbi vullnetin e lirë të tij mund të lexohet nga Gjykata vetëm në kuptimin më të gjerë të mundshëm, duke ndaluar çdo sjellje nga ana e organeve të zbatimit të ligjit që mund të lërë shteg për dyshime se vullneti i personit të marrë në pyetje është dhunuar. Neni 25 i Kushtetutës sonë ndalon çdo lloj forme torture ose trajtimi çnjerëzor, kurse neni 32 i Kushtetutës parashikon dy ndalime: së pari, që askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetvetes dhe as të pohojë fajësinë dhe, së dyti, që askush nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. ...Gjykata vlerëson se në çështjen në shqyrtim vërehen dyshime serioze për kushtet dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij për veprën për të cilën akuzohet. ...Çdo i pandehur ka absolutisht të drejtë që të mos japë asnjë lloj kontributi gjatë hetimit gjyqësor ose gjatë procesit dhe kjo është një e drejtë e pamohueshme.<sup>38</sup>*

#### **iv) E drejta e të akuzuarit për të heshtur**

E drejta e të akuzuarit për të mos dhënë shpjegime gjatë marrjes në pyetje shtrihet që në fazën e hetimit paraprak të procedimit penal nga policia gjyqësore dhe deri në zhvillimin e gjykimit të çështjes. *I akuzuari duhet të ketë të drejtën të mos japë shpjegime, në mënyrë që ai të mos zbulojë përpara se të fillojë procesi gjyqësor strategjinë e tij të mbrojtjes në gjykim.* Legjislacionet e shteteve evropiane e njohin të drejtën e të akuzuarit për të qëndruar i heshtur dhe për të mos iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga oficerët e policisë gjyqësore apo prokurori/gjyqtari i hetimeve paraprake. Megjithatë, mënyra se si i akuzuari informohet për të drejtën e tij për të mos folur nuk është e njëjtë në të gjitha shtetet, ndaj, që kjo e drejtë të garantohet në mënyrë efektive, duhet që i akuzuari të informohet (vihet në dijeni) nga personi që e merr në pyetje për të drejtën që ka, sikundër është parashikuar në KPP me reformën e vitit 2017 – letra e të drejtave (neni 255, pika 3).

Në këtë aspekt legjislatori shqiptar, duke reflektuar përvojën ligjore të shumicës së vendeve evropiane, është treguar mjaft i kujdesshëm që *një të drejtë të tillë ta parashikojë në mënyrë eksplicite në KPP*, bashkë me paralajmërimin se nëse nuk dëshiron të përfitojë nga një e drejtë e tillë, çdo gjë që ai do të thotë, mund të përdoren ndaj tij në gjykim.<sup>39</sup>

<sup>37</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së në çështjen *Funke kundër Francës*, datë 25.02.1993, çështja nr. 10828/84, në përmbledhjen A 256-A

<sup>38</sup> Vendimi nr. 14, datë 03.05.2011, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i sipërcituar.

<sup>39</sup> Neni 255, pika 1 e KPP parashikon si një nga detyrat me të rëndësishme të oficerëve apo agjentëve të policisë gjyqësore kur kryejnë një arrestim apo ndalim, atë të vënies menjëherë në dijeni të personit që i kufizohet liria që “*nuk ka asnjë detyrim të bëjë deklarata*”.

Një pjesë e shteteve që nuk e parashikojnë në mënyrë eksplicite një të drejtë të tillë, parashikojnë në legjislacionin e tyre se provat e marra, pa u respektuar e drejta e të akuzuarit për t'u informuar për të drejtën për të mos folur, nuk mund të përdoren në gjykim, ndërsa disa të tjera ometimin e kryerjes së një veprimi të tillë e lidhin me pasojën e pasjes së përgjegjësisë penale të funksionarit që ka marrë në pyetje të akuzuarin, ose një fakt i tillë shërben si shkak për të ankimuar vendimin e dënimit që është bazuar në një provë të tillë.

*E drejta e të akuzuarit për të qëndruar i heshtur nuk është, megjithatë, absolute. Disa elementë na lejojnë të përcaktojmë nëse e drejta për një proces të drejtë është shkelur në hipotezën që një gjykatë ka nxjerrë përfundime të pafavorshme për të akuzuarin nga qëndrimi i heshtur i tij. Konkluzione të tilla mund të nxirren, veçse kur prokuroria ka paraqitur prova që në pamje të parë (prima facie) e implikojnë një person në kryerjen e një veprë penale. Pas këtij momenti, gjyqtari gëzon pushtetin diskrecionar për të nxjerrë ose jo konkluzione nga faktet e çështjes, ashtu siç kanë rezultuar në gjykim. Vetëm përfundimet e bazuara mbi common sense janë të pranueshme dhe në vendimin gjyqësor përfundimtar duhet të pasqyrohen arsyet mbi të cilat është bazuar ky vendim. Provat kundër të pandehurit duhet të jenë të pakundërshtueshme; në një rast të tillë mund të përdoren edhe prova të marra nëpërmjet presionit indirekt.<sup>40</sup>*

Në çështjen *Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ ka konkluduar që, nëse organi i akuzës ka paraqitur prova që në pamje të parë tregojnë se një person e ka kryer veprën penale që i atribuohet dhe në qoftë se barra e provës për të vërtetuar akuzën vazhdon t'i mbetet organit të akuzës, atëherë mund të nxirren përfundime jo në favor të të pandehurit, duke marrë shkas nga heshtja e tij. Detyrimi i të pandehurit për të bërë deklarime nuk është konsideruar nga Gjykata e Strasburgut se bie në kundërshtim me KEDNJ-në, ndërkohë që do të përbënte shkelje të kësaj konvente nëse dënimi i një personi do të bazohej vetëm ose kryesisht mbi refuzimin për të deklaruar.

*Të nxjerrësh përfundime jo të favorshme për të pandehurin që refuzon të flasë mund të konsiderohet si shkelje e parimit të prezumimit të pafajësisë, duke mbajtur parasysh rëndësinë që gjyqtari kombëtar (gjykata e brendshme) do t'i japë kësaj heshtjeje, në raport me vlerësimin e të gjithë elementëve provues, dhe të shkallës së shtrëngimit të ushtruar. Provat e akuzës duhet të jenë mjaftueshmërisht të qëndrueshme, për t'i bërë ballë çdo kundërshtimi nga ana e të pandehurit dhe mbrojtjes së tij. Gjyqtari kombëtar nuk ta deklarojë fajtor të pandehurin vetëm se ky i fundit ka përfituar nga e drejta për të mos folur (heshtur).*

*Vetëm atëherë kur provat e paraqitura nga organi i akuzës “kërkojnë” një shpjegim nga ana e të pandehurit, në eventualitetin e refuzimit të tij për të dhënë shpjegime, mund të nxirren përfundime të arsyeshme, që nuk ekziston asnjë shpjegim i mundshëm për të kundërtën dhe, për pasojë, i pandehuri është fajtor. Në të kundërt, nëse argumentet e paraqitura nga organi i akuzës kanë një fuqi provuese aq të dobët, saqë nuk mund t'i rezistojnë kundërshtimeve të palës tjetër, përfitimi nga e drejta për të heshtur nga ana e të pandehurit nuk mund të çojë në përfundimin se ky person është fajtor. GJEDNJ ka saktësuar se përfundimet e arsyeshme të nxjerra nga sjellja e të pandehurit nuk duhet të kenë efekt në zhvendosjen e barrës së provës nga akuza tek mbrojtja, duke dhunuar në këtë mënyrë parimin e prezumimit të pafajësisë.*

---

<sup>40</sup> Shih “*Livre Vert sur la présomption d'innocence*” të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, të sipërcituar, f. 8-9.

GJEDNJ nuk ka vendosur nëse kjo e drejtë zbatohet edhe për personat juridikë. Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian ka deklaruar se personat juridikë nuk kanë një të drejtë absolute për të ruajtur heshtjen; ato duhet t'i përgjigjen pyetjeve në lidhje me faktet e çështjes, por nuk duhet të detyrohen të pranojnë ekzistencën e një veprë penale.<sup>41</sup>

#### v) E drejta e të akuzuarit për të mos kontribuar në krijimin e prova që e fajësojnë atë

Parimi sipas të cilit një gjykatë duhet të ketë akses në të gjithë elementët provues (të gjitha provat) është kapërcyer nga nevoja për të pasur një proces gjyqësor të drejtë dhe nga kufizimi i rrezikut që i pandehuri të dënohet mbi bazën e deklaramëve të tij.<sup>42</sup> Në përcaktimin e fushës së zbatimit të kësaj të drejte, GJEDNJ, në vendimet e saj, ka përcaktuar dallimin ndërmjet materialit provues të mbledhur me mjete shtrënguese (detyruese) dhe materialit tjetër provues që ekziston në mënyrë të pavarur nga vullneti i të pandehurit; “e drejta për të mos implikuar vetveten ka të bëjë, në radhë të parë (...) me respektimin e vendimit të marrë nga i pandehuri për të qëndruar i heshtur (për të mos folur). Siç përgjithësisht dihet, kjo e drejtë nuk shtrihet në përdorimin në një procedim penal të materialit provues që mund të jetë përftuar nga i pandehuri duke iu drejtuar mjeteve shtrënguese, por që ekzistojnë pavarësisht vullnetit të të akuzuarit, si, *inter alia*, dokumentet e mbledhura në zbatim të një vendimi gjyqësor, pjesë të pështymës, gjakut, urinës dhe të indeve trupore me qëllim kryerjen e analizës së ADN-së”.<sup>43</sup>

Kur duhet nxjerrë një vendim nga organi procedues që urdhëron prodhimin e një dokumenti apo autorizon kryerjen e një kontrolli i vendeve apo lokaleve dhe/apo sekuestrimi i sendeve, provë materiale apo në cilësinë e *corpus delicti*, ky vendim duhet të ketë një objekt të saktë, të mirëpërcaktuar, me qëllim që të evitohet përdorimi i vendimeve me objekt të përgjithshëm, që bëhen për të justifikuar kërkimet e rastësishme të informacioneve komprometuese, në rastet kur nuk ekzistojnë veçse dyshime të turbullta (të paqarta) ndaj një personi.

Ekziston problemi i zbatimit të së drejtës për të mos prodhuar prova që i fajësojnë tek personat juridikë. Gjykata e Drejtësisë e Komunitetit Evropian dhe Gjykata e Shkallës së Parë kanë vendosur që kjo e drejtë nuk gjen zbatim në rastin e persona juridikë. Këtyre të fundit mund t'u kërkohet paraqitja (hartimi) e dokumenteve.<sup>44</sup>

## 4. Përfundime

Prezumimi i pafajësisë gëzon një mbrojtje të veçantë në vendin tonë. Ai është parashikuar që në ligjin themelor dhe përbën një nga parimet madhore të procesit gjyqësor penal dhe një nga shtyllat ku mbështetet e drejta për një procesi të rregullt ligjor. Një rëndësi të veçantë këtij parimi i jep

<sup>41</sup> Shih vendimin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJED), *Orkem kundër Komisionit Evropian*, datë 18 tetor 1989, çështja C-374/87, paragrafët 34-35, në linkun e mëposhtëm:

<https://curia.Evropa.eu/juris/liste.jsf?td=ALL&language=en&jur=C.T.F&num=C-374/87>

<sup>42</sup> Shih vendimin e GJEDNJ-së, Dhoma e Madhe, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 17 dhjetor 1996, çështja nr. 19187/91, në: <file:///C:/Users/HP/Downloads/001-62568.pdf>

<sup>43</sup> Vendimi i GJEDNJ-së *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i sipërcituar.

<sup>44</sup> Shih vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Bashkimit Evropian, *Mannesmannröhren-Werke kundër Komisionit Evropian*, çështja T-112/98, pika 65, në linkun e mëposhtëm:

<https://curia.europa.eu/juris/showPdf.jsf?text=&docid=46192&pageIndex=0&doclang=EN&mode=req&dir=&oc=first&part=1&cid=5477670>



edhe jurisprudenca e Gjykatës sonë Kushtetuese<sup>45</sup> dhe sidomos ajo e Gjykatës së Strasburgut, vendimet e shumta të së cilës, në këtë aspekt, shërbejnë si udhërrëfyes në zbatimin e këtij parimi në çështje të ngjashme.

Gjykata jonë Kushtetuese është shprehur se prezumimi i pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Prezumimi i pafajësisë përbëhet nga disa aspekte, njëri prej të cilit është *in dubio pro reo*, pra çdo dyshim shkon në favor të të pandehurit dhe barra e provës bie kryesisht mbi organin e akuzës. Gjykata e ka interpretuar prezumimin e pafajësisë në kuptimin që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit, se gjykata duhet ta mbështesë vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuzat, duke saktësuar se “*ky interpretim i nenit 30 të Kushtetutës lidhet ngushtësisht me proceset penale*”.

Në dritën e vendimeve të GJEDNJ-së legjislativi kushtetues dhe ai procedural penal i vendit tonë ka parashikuar në mënyrë të shprehur, të qartë dhe të saktë format e shfaqjes së parimit të prezumimit të pafajësisë, duke parashikuar të drejtën e të akuzuarit që të mos dëshmojë kundër vetes ose familjes së vet (neni 32, pika 1 e Kushtetutës, nenet 36, 37 e 158 të KPP); të drejtën e heshtjes, pra të mospërgjigjjes ndaj pyetjeve të drejtuara nga organi i ndjekjes penale dhe/apo gjykata (neni 28, pika 1 e Kushtetutës, nenet 166 e 296 të KPP) dhe të drejtën e një procesi të rregullt ligjor në të gjitha rastet e shqyrtimit të akuzave penale (neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 § 1 i Konventës për të Drejtat e Njeriut) dhe përcaktimit të fatit të sendeve që provohet se kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale ose se janë produkte të nxjerra prej tyre (neni 190 i KPP-së në lidhje me nenin 36 të Kodit Penal).

Nga shqyrtimi i çështjeve kundër Shqipërisë në Gjykatën e Strasburgut konstatohet se në asnjë rast vendi ynë nuk është gjetur fajtor për shkeljen e parimit të prezumimit të pafajësisë. Po kështu, as Gjykata jonë Kushtetuese nuk ka vërejtur shkelje të këtij parimi në gjykimet penale, në rastet kur një pretendim i tillë është parashtruar përpara saj. Ky fakt është tregues i kujdesit që bëjnë organet e procedimit penal në zbatimin dhe garantimin e këtij parimi themelor të procedimit të drejtë.

Një kujdes më i madh duhet treguar nga personat zyrtarë në rastet kur, në fjalimet e tyre publike i referohen procese gjyqësore në gjykim e hetim, duke mos u treguar shumë të matur në respektimin e këtij parimi dhe duke arritur në konkluzione fajësie për personat ende në procedurë gjyqësore. Autoritetet shtetërore mundën, megjithatë, të informojnë publikun në lidhje me hetimet paraprake dhe të shprehin dyshime në lidhje me fajësinë, mjafton që këto dyshime të mos përbëjnë një deklaratë fajësie për të akuzuarin dhe autoritetet të demonstrojnë maturi.<sup>46</sup>

Nga e njëjta vetëpërmbytje duhet të karakterizohen edhe organet e shtypit të shkruar dhe masmedias elektronike që të tregohen të matur dhe vigjilentë për të mos kaluar cakun e të drejtës së mbrojtur ligjrisht, prezumimin e pafajësisë, duke shmangur komentet apo konkluzionet në lidhje me fajësinë e personit nën hetim. Kualifikimi i gazetarëve që përcjellin lajmet që lidhen me

---

<sup>45</sup> Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese: nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 19, datë 18.9.2008, si dhe nr. 9, datë 28.4.2004.

<sup>46</sup> Vendim i GJEDNJ-së *Krause kundër Zvicrës*, çështja nr. 7986/77, 13 DR 73 (1978).

sistemin e drejtësisë është shumë i nevojshëm, pasi vetëm kështu do të minimizohen rastet e shkeljes së këtij parimi.

Ndoshta ka ardhur koha që prezumimi i pafajësisë të parashikohet si një e drejtë e personalitetit të personit fizik, duke u parashikuar si e tillë dhe duke u marrë në mbrojtje nga Kodi Civil, në pjesën e përgjithshme të tij, si dhe duke u sanksionuar e drejta për dëmshpërblim në rast të cenimit të tij. Përvoja franceze në këtë drejtim është shumë e vyer dhe mund të shërbejë si pikë orientimi për një reformë të pritshme në të ardhmen.

Në përfundim mund të themi se parimi i prezumimit të pafajësisë ka gjetur njohje, garantim e përkrahje të gjithanshme në legjislacionin dhe jurisprudencën shqiptare, duke iu dhënë vendi i merituar dhe rëndësia respektive, në pajtim me karakterin dhe peshën që ky parim ka në strukturën e procesit të drejtë, të marrë në mbrojtje nga neni 42 i Kushtetutës sonë dhe neni 6 §§ 1&2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

\*\*\*

## **BIBLIOGRAFIA:**

1. Ligji nr. 8417, datë 21.11.1998 “*Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
2. Ligji nr. 7905, datë 21.3.1995 “*Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar.
3. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.
4. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Transnacional.
5. Ligji nr. 9284, datë 30.09.2004 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar*”.
6. Ligji nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”.
7. Jean Pradel “*Manuel de Procédure Pénale*”, 14<sup>e</sup> Édition, revue et augmentée, shtëpia botuese “Cujas”, Paris, gusht 2008.
8. P. Béliveau dhe J. Pradel “*La justice pénale dans les droits canadien et français*”, 1986, shtëpitë botuese Blais (Montréal) e Cujas (Paris).
9. K. Tiedemann, “*Les mouvements de reforme de la procédure pénale et la protection des droits de l’homme*”, Revue international de droit pénal, 1993, volumni 64.
10. Christine Lazerges “*La présomption d’innocence en Europe*”, Archives de politique criminelle, 1/2004 (n° 26).
11. Valentine Bück, “*L’influence des cours constitutionnelles sur la politique pénale*”, Studim krahasues Francë & Spanjë, LGDJ, 2002.
12. G. Fiandaca & G. Di Chiara, “*Una introduzione al sistema penale. Per una lettura costituzionalmente orientata*”, shtëpia botuese “Jovene”, Napoli, 2003.
13. Giovanni Catalisano, “*Il libro verde sulla presunzione di non colpevolezza*”.
14. “*Livre Vert sur la présomption d’innocence*” të Komisionit të Komuniteteve Evropiane, Bruksel, 26.04.2006, COM (2006) 174.
15. Vendimi i GJEDNJ-së Barberà, Messegué dhe Jabardo kundër Spanjës, datë 6 dhjetor 1988, seritë A 146 (1989).

16. Vendimi i GJEDNJ-së *Minelli kundër Zvicrës*, datë 25 mars 1983, kërkesa nr. 8660/79, A 62 (1983);
17. Vendim i GJEDNJ-së *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 8 shkurt 1996, kërkesa nr. 18731/91, në përmbledhjen 1996-I;
18. Vendim i GJEDNJ-së *Telfner kundër Austrisë*, datë 20 mars 2001, kërkesa nr. 33501/96.
19. Vendim i GJEDNJ-së *X. kundër Republikës Federale të Gjermanisë*, çështja nr. 4483/70.
20. Vendim i GJEDNJ-së *Krause kundër Zvicrës*, çështja nr. 7986/77, 13 DR 73 (1978).
21. Vendim i GJEDNJ-së *Salabiaku kundër Francës*, datë 07.10.1988, seria A (141).
22. Vendim i GJEDNJ-së *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë*, në çështjen nr. 52024/99, datë 5 korrik 2001.
23. Vendim i GJEDNJ-së *Bongiorno dhe të tjerë kundër Italisë*, nr. 4514/07, datë 5 janar 2010.
24. Vendim i GJEDNJ-së *Arcuri dhe të tjerë kundër Italisë*, në çështjen nr. 52024/99, datë 5 korrik 2001.
25. Vendim i GJEDNJ-së *Welch kundër Britanisë së Madhe*, datë 9 shkurt 1995, çështja nr. 17440/90.
26. Vendim i GJEDNJ-së *Philips kundër Britanisë së Madhe*, datë 5 korrik 2001, çështja nr. 41087/98.
27. Vendim i GJEDNJ-së *Heaney dhe McGuinness kundër Irlandës*, datë 21 dhjetor 12.2000, çështja nr. 34720/97.
28. Vendim i GJEDNJ-së *Funke kundër Francës*, datë 25 shkurt 1993, çështja nr. 10828/84, në përmbledhjen A 256-A.
29. Vendim i GJEDNJ-së *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, datë 17 dhjetor 1996, çështja nr.19187/91, në përmbledhjen 1996-VI.
30. Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë të Bashkimit Evropian, *Orkem kundër Komisionit Evropian*, çështja T-374/87, Përmbledhja 1989, f. 3283.
31. Vendim i Gjykatës së Drejtësisë të Komuniteteve Evropiane, *Mannesmannröhren-Werke kundër Komisionit Evropian*, çështja T-112/98, Përmbledhja 2001.
32. Vendimi nr. 2001-455, datë 12 janar 2001, i Këshillit Kushtetues francez.
33. Vendimi i datës 14 prill 1976, i Gjykatës Kushtetuese të Republikës italiane.
34. Vendimet nr. 47, datë 7.11.20011; nr. 14, datë 3.5.2011; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 23, datë 23.7.2009; nr. 16, datë 15.6.2009; nr. 9, datë 28.4.2009; nr. 19, datë 18.9.2008 dhe nr. 9, datë 28.4.2004 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.
35. Vendimet nr. 734, datë 21.11.2007; nr. 600, datë 19.9.2007 dhe nr. 154, datë 29.3.2006, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.